



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

**Seksioni për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të të tretëve që
veprojnë për llogari të tyre**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok.202100216/39

Tiranë ___/___/2024

Lënda: *Rekomandohet paraqitja e kërkesës pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për zgjidhjen e çështjes së kompetencës administrative në trajtimin e çështjes për mirëmbajtjen dhe lirin tërësisht të rrugës hyrëse në "Rrugën e Kombit", por jo vetëm, nga Qyteti i Kuksit.*

Drejtuar: **Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë**

TIRANË

Autoriteti Rrugor Shqiptar

TIRANË

Bashkia

KUKËS

Për dijeni: **S. D**

Fshati Kodër-Lum

KUKËS

Të nderuar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike, ka pranuar për shqyrtim ankesën datë 03.02.2021, të shtetasit S. D. Në këtë ankesë, shtetasi prezanton shqetësimin e mosveprimit nga organi/subjekti i ngarkuar me detyrimin e mirëmbajtjes dhe liritimit

tërësisht të rrugës hyrëse në “*Rrugën e Kombit*”, por jo vetëm, nga Qyteti i Kuksit. Në përputhje me nenin 13, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “*Për Avokatin e Popullit*”, të ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarrë shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Sikundër thuhet shprehimisht në këtë ankesë, segmenti rrugor nga Fshati Kodër-Lum, Shtiqën, për në qytetin e Kuksit, pjesa hyrëse për në “*Rrugën e Kombit*”, ndodhet në kushtet e zënies së njerës prej korsive të lëvizjes së automjeteve, për shkak të rrëshqitjes së dherave dhe gurëve, të cilat sa vijnë e bllokojnë rrugën.

Banori i kësaj zone, ankuesi z. S. D, shprehet se ky segment rrugor është mjaft i frekuentuar nga automjetet, pasi është dalja veriore e qytetit. Më tej, ankuesi, shpreh shqetësimin e rrezikshmërisë në lëvizjen me automjet në këtë segment rrugor, si dhe ankohet ndaj organit kompetent Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH) apo Bashkisë Kukës, për mosveprim në normalizimin e kushteve teknike të lëvizshmërisë në këtë segment rrugor.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke e vlerësuar të drejtë dhe të ligjshëm shqetësimin e ngritur nga banori/shtetasi i lartpërmendur, kërkon vëmëndjen tuaj për trajtimin e kësaj problematike shqetësuese e cila rrezikon lëvizjen e lirë me automjet të çdo individi në këtë segment rrugor. Nisur nga kjo gjendje e prezantuar, me marrjen në shqyrtim të këtij rasti, kemi kërkuar informacion dhe shpjegime nga ana e ARSH-së, sipas kompetencave respektive ligjore për këtë problematikë, përsa i përket trajtimit që po i bëhej kësaj çështjeje dhe masave që do të ndërmerreshin për zgjidhjen e saj.

Në përgjigjen e dhënë ARSH-ja, me shkresën nr.1764/1 prot., datë 26.02.2021, sqaron ndër të tjera, se:

“Nga ana jonë është vënë në dijeni Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila është Autoriteti Kontraktor i Kontratës Konçesionare.

Bazuar në Klauzolën 10.3 të marrëveshjes së Konçesionit, “Rrugë e Degëzimit” citohet:

“Autoriteti Kontraktor do të sigurojë që Autoriteti përkatës ofron, operon dhe mirëmban si duhet rrugët e degëzimit për në Autostradë në një standart të mjaftueshëm në përputhje me ligjin, në mënyrë që të sigurojë lëvizjen e lirë dhe qasje të vazhdueshme të trafikut në këto rrugë degëzimi në

Autostradë”. Përsa më sipër, Shoqëria Konçesionare “Albania Highway Concession” Shpk, është përgjegjëse për mirëmbajtjen e këtij segmenti rrugor”.

Bashkëlidhur shkresës nr.1764/1 prot., datë 26.02.2021, ARRSH-ja, ka vendosur në dispozicion kopje të shkresës nr.1349/1 prot., datë 10.02.2021, dërguar Bashkisë Kukës, për këtë çështje, në përgjigje të kërkesës së saj për zgjidhjen e situatës në segmentin rrugor në fjalë. Po kështu, bashkëlidhur kësaj shkrese, ARRSH-ja, ka bashkëngjitur kopje të shkresës nr. 588 prot., datë 10.02.2021, që Bashkia Kukës i ka dërguar Ministrin të Infrastrukturës dhe Energjisë për ndërhyrje të shpejtë në zgjidhjen e problemit në fjalë.

Referuar këtij dokumentacioni, ka rezultuar se palët kanë pasur mosmarrëveshje mes tyre Olidhur me subjektin që ka kompetencën territoriale në shqyrtimin/trajtimin e situatës në segmentin rrugor të lartpërmendur.

Në vijim të procesit të shqyrtimit të kësaj çështjeje, Institucioni ynë, ka kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ARRSH-së dhe Bashkisë Kukës, ndër të tjera, me shkresat nr.K3/S5-5 prot., datë 21.05.2021, nr.K3/S5-12 prot., datë 28.07.2022 dhe nr.K3/S5-20 prot., datë 14.11.2022, informacion dhe shpjegime lidhur me:

- vlerësimin e gjendjes në segmentin rrugor që përmend ankuesi. Mundësitë e ndërhyrjes sa më parë për normalizimin e infrastrukturës së qarkullimit, referuar marrëveshjes së lidhur me subjektin koncesionar “Albanian Highway Concession” Sh.p.k.;
- veprimtarinë administrative të mundshme të zhvilluar për zgjidhjen e mosmarrëveshtjes së kompetencës administrative territoriale, lidhur me përcaktimin e subjektit që ka detyrimin e mirëmbajtjes së segmentit rrugor në fjalë;
- prezantimin e mundshëm për zgjidhje të çështjes së kompetencës territoriale në rrugë gjyqësore.

Në përgjigje të kërkesës për informacion dhe shpjegime, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, respektivisht me shkresat nr.1005 prot., datë

31.01.2022, nr. 1005/4 prot., datë 28.12.2022, dhe nr. 5669/1 prot., datë 04.08.2023, drejtuar Avokatit të Popullit, shprehet, midis të tjerave, se:

“...Segmenti në të cilin ka ndodhur problematika, nuk ndodhet në territorin e Autostradës Milot-Morinë, si rrjedhojë shoqëria konçesionare “Albanian Highway Concession” Sh.p.k. nuk ka detyrim të mirëmbajtje ose të ndërhyjë në segmentin rrugor të sipërcituar”;

“... referuar materialit (sipas të cilit është përcaktuar territori i dorëzuar konçesionarit) të shkresave nr.286/1 prot, ARRSH, datë 18.01.2018, dhe nr.7964/3 prot, ARRSH, datë 14.10.2021, segmenti (i cili është ndërtuar nga ana e ARRSH) në të cilin ka ndodhur problematika, është jashtë territorit të projektit, dorëzuar shoqërisë konçesionare”;

“... Referuar Aneksit 5 “Inventari i skarpateve dhe shkarjeve”, zona në të cilën ka ndodhur rrëshqitja nuk është përfshirë si skarpatë dhe nuk ka asnjë dokumentacion hartografik i cili provon që rrëshqitja e dherave është pjesë e inventarit të Autostradës Milot-Morinë.

... Përsa kohë që MIE, shoqëria konçesionare “Albanian Highway Concession” Sh.p.k., si dhe inxhinjieri i pavarur “Dolstar Engineering Inc.Co”, janë të qartë në qëndrimin e tyre mbi territorin e projektit, të cilin e kemi shpjeguar edhe me shkresat e mëprashme, atëhere MIE nuk ka patur arsye që ta zgjidhë këtë çështje në rrugë gjyqësore”.

Shprehja e qëndrimit si më sipër cituar, bazohet në konstatimin e kryer në terren nga ana e MIE dhe inxhinierit të pavarur të kontratës konçesionare “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Autostradës Milot-Morinë” (shih-aktin datë 23.02.2021, të ing.S. A.), si dhe vizitën/takimin e kryer më datë 10.05.2023 në objekt, midis përfaqësuesit të Njësisë së Zbatimit të Projektit “Milot-Morinë”, ARRSH-së, shoqërisë konçesionare “Albanian Highway Concession” Sh.p.k., si dhe inxhinierit të pavarur “Dolstar Engineering Inc.Co”.

Bashkia Kukës, në përgjigje të kërkesës për informacion dhe shpjegime, me shkresat nr. 5412/1 prot., datë 30.09.2022, nr. 6605/1 prot., datë 22.11.2022 dhe nr. 933/1 prot., datë 20.02.2024, drejtuar Avokatit të Popullit, shprehet midis të tjerave, se:

“... Bashkia Kukës, në mënyrë të përsëritur ka kërkuar zyrtarisht nga ARRSH-ja, Njësia e Zbatimit të Projektit Milot-Morinë” pranë MIE, nga Shoqëria “Albanian Highway Concession” Sh.p.k., ndërhyrjen për stabilizimin përfundimtar të këtij segmenti të rrugës nga ana e Shoqërisë Konçesionare, në zbatim të marrëveshjes së konçesionit, bazuar në klauzolën 10.3 të kësaj marrëveshjeje për “Rrugët e degëzimit”.

Kërkesa e Bashkisë Kukës, është vlerësuar e drejtë edhe nga ARRSH-ja përse i përket adresimit të këtij problem tek Shoqëria Konçesionare pasi vlerësohet edhe nga ARRSH-ja se kjo Shoqëri ka detyrimin ligjor për të ndërhyrë për stabilizimin e këtij segmenti të rrugës, në zbatim të marrëveshjes së sipërcituar.

Ne kemi përcjellë zyrtarisht shqetësimin tonë jo vetëm për gjendjen e rrugës por edhe për rrezikun që ju kanoset disa familjeve që kanë shtëpitë e tyre në zonën sipër rrugës që ndodhen afër me terrenin që rreshqet sidomos me fillimin e stinës me reshje”;

“...Në një nga përgjigjet e Inxhinierit të pavarur për projektin e koncesionit ndër të tjera thuhet” - Ky segment rrugor nuk na përket sepse nuk është pjesë e kufirit të pronës së autostradës...

Bashkia Kukës, lidhur me pretendimet e sipërshënuara ju bën të qartë se ato nuk qëndrojnë pas ky segment rrugor nuk ka ekzistuar para vitit 2009, pra është hapur kur ka filluar puna për ndërtimin e autostradës për të shërbyer si rrugë hyrëse në autostradë për Morinë.

Edhe rruga lidhëse e fshatit Shtiqën me qytetin dhe hyrja në autostradë për Morinë nuk ka ekzistuar më parë por është ndërtuar pas vitit 2009”;

“Nëse i referohemi ortofotove me pamje nga terreni përpara ndërtimit të autostradës, para vitit 2009, gjithëkush bindet, (pasi është lehtësisht e verifikueshme) se segmenti i rrugës ku ka ndodhur rrëshqitja e dherave nuk ka ekzistuar fare si rrugë, dhe se, kjo rrëshqitje është aktivizuar sapo është ndërtuar ky segment rruge që shërben si rrugë lidhëse e qytetit të Kuksit me Autostradën Milot-Morinë.

Për zgjidhjen e këtij problemi, Bashkia Kukës, ka qenë gjithnjë e gatshme t'i bashkohet çdo grupi inspektimi me specialistë nga institucionet përkatëse për të verifikuar situatën në terren, apo për të shprehur mendimet lidhur me

kompetencat dhe mundësitë e ndërhyrjes për eliminimin e kësaj rrëshqitje që vazhdon të mbetet shqetësim për përdoruesit e rrugës”.

Më tej, ARSSH me shkresat nr. 8967/1 prot., datë 03.10.2022 dhe nr. 86 prot., datë 06.01.2023, shprehet, midis të tjerave, se:

“ARRSH inspektoi në terren problematikën në prani të përfaqësuesve të Bashkisë Kukës, dhe vuri re për aq sa ishte e mundur në këtë inspektim se plani i rrëshqitjes është mbi territorin e projektit/kufirit të shpronësimit të projektit “Ristudim projekti, Rruga Kukës-Morinë, km 9-km 11.75. ...”;

... Referuar kontratës konçesionare “Ndërtim, përmirësim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e Autostradës Milot-Morinë, miratuar me VKM nr.870, datë 14.12.2016, kontratë e lidhur midis shoqërisë konçesionare “Albanian Highway Concession” Sh.p.k., dhe me autoritet kontraktor MIE, e përfaqësuar në këtë kontratë nga Njësia e Zbatimit të Projektit Milot-Morinë”, klauzola nr.10.3 e kësaj kontrate, si dhe shtojcën nr.9 të saj, ky segment rrugor cilësohet në km 97+100 si “Rruga dalëse për Kukës” dhe është në mirëmbajtje nga kjo kontratë deri në përfundim të periudhës konçesionare”.

Konstatohet se, në ndryshim nga qëndrimi i mbajtur prej ARSSH-së në shkresat nr. 8967/1 prot., datë 03.10.2022 dhe nr. 86 prot., datë 08.01.2023, drejtuar Avokatit të Popullit, MIE, shprehet se është Bashkia Kukës, organi i cili ka kompetencën për rehabilitimin e segmentit rrugor të dëmtuar.

Referuar deklarimeve të sipërcituara, konstatohet gjithashtu, se, MIE, ARSSH, Bashkia Kukës, apo subjekti Shoqëria konçesionare “Albanian Highway Concession” shpk.¹, shprehen për mungesë kompetence territoriale në trajtimin e çështjes së mirëmbajtjes të segmentit rrugor në të cilin ka ndodhur rrëshqitja e dherave.

Në kushtet e mosmarrëveshjes për zgjidhjen e çështjes, Institucioni i Avokatit të Popullit, me shkresën nr. K3/S5-26 prot., datë 21.02.2023, ka kërkuar

¹ Në shkresën datë 07.12.2022 të shoqërisë konçesionare, drejtuar ARSSH-së, Bashkisë Kukës dhe Njesisë së Zbatimit të Projektit, shoqëria konçesionare ka mbajtur qëndrimin se ajo nuk e ka marrë segmentin rrugor në fjalë në inventarin fillestar, si pjesë të autostradës Milot-Morinë dhe se klauzola 10.3 [e kontratës] nuk specifikohet për Konçesionarin por për të gjithë autoritetet që kanë kompetenca në RSH.

MIE-s informacion nëse është nxjerrë akt për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës në trajtimin e çështjes objekt prezantimi.

Në përgjigje të kërkesës, MIE, me shkresën nr. 828/1 prot., datë 22.02.2023, shpreh përsëri të njëjtin qëndrim sikurse në shkresën nr.1005 prot., datë 31.01.2022 dhe nr. 1005/4 prot., datë 28.12.2022, drejtuar Avokatit të Popullit, se:

“...Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse, për inventarizimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve në territorin përkatës, duke bërë të gjitha përpjekjet e mundshme, brenda fushëkompetencës së tyre ligjore, për të siguruar burimet e nevojshme, me qëllim shmangien e problematikave...”

Edhe pse çështja objekt prezantimi prej vitesh nuk po merr rrugën e zgjidhjes, për shkak të mosmarrëveshjes së kompetencës territoriale, konstatohet se, asnjë prej organeve nuk ka kryer veprimtari për zgjidhjen e saj në rrugë gjyqësore.

Mosarritja e marrëveshjes për kompetencë territoriale në trajtimin e çështjes në fjalë, mund dhe duhet të bëhet objekt zgjidhjeje në rrugë gjyqësore. Cilido organ publik ka pasur dhe ka mundësinë të kërkojë në rrugë gjyqësore zgjidhjen e çështjes, në përputhje me nenin 27, paragrafi 2, pika c), dhe neni 27, paragrafi 3 i Kodit të Proçedurës Administrative (KPA), ku parashikohet se:

“Mosmarrëveshjet e kompetencave

...2. Në rast se ato nuk arrijnë në një marrëveshje, konflikti zgjidhet nga: ...

c) gjykata administrative, për të gjitha rastet e tjera, për të cilat ajo është kompetente.

3.Zgjidhja e konfliktit mund të kërkohet nga secili prej organeve të përfshira, me marrjen dijeni të konfliktit”

Prej më shumë së tre viteve, organet tuaja përcjellin çështjen për trajtim pranë njëra- tjetrës, duke lënë atë pa zgjidhje, për shkak të vlerësimit të moskompetencës tokësore në trajtimin e saj. Ky qëndrim i mbajtur në trajtimin e çështjes në fjalë, nuk mund të vlerësohet në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe përgjegjësisë, sikurse parashikuar në nenet 4 dhe 15 të KPA, se:

“Parimi i ligjshmërisë

1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor”;

“Parimi i përgjegjësisë

Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin përkatës”.

Neni 4 i KPA përcakton sundimin e ligjit si parimin bazë më të rëndësishëm për kryerjen e procedurave administrative. Ky nen bën të qartë se jo vetëm duhet të respektohet legjislacioni i zbatueshëm i Republikës së Shqipërisë, por edhe Kushtetuta dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Përveç kësaj, sipas nenit 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet publike duhet të respektojnë edhe aktet e tjerë normativë që kanë fuqi juridike.

Nisur sa sipër, sipas nenit 4, paragrafi 1 të Kushtetutës shqiptare dhe nenit 4 të KPA., e drejta përbën bazën dhe kufijtë e të gjitha veprimtarive të shtetit që nënkupton të gjitha veprimtaritë e organeve publike dhe të enteve të tjera. Kjo do të thotë që:

- Të gjitha veprimtaritë e subjekteve publike, veçanërisht të organeve publike duhet të jenë të përputhje me ligjin;
- Për të përmbushur kërkesat ligjore duhet të zbatohen dispozitat e ligjit;
- Cenimi i të drejtave subjektive apo interesave të ligjshme duhet të bazohet në ligj (*neni 4, paragrafi 2 i KPA*).

Pra, neni 4 i K.Pr.A. kërkon që organet publike të ushtrojnë veprimtaritë e tyre “në përputhje me qëllimin për të cilin u janë dhënë këto kompetenca”. Kjo do të thotë që ligji duhet të interpretohet dhe të zbatohet sipas metodave gjyqësore profesionale duke përfshirë objektivat ligjorë, të cilat duhet të nxirren me anë të interpretimit dhe analizës së procesit legjislativ.

Neni 4, paragrafi 2 i KPA thekson rëndësinë e mbrojtjes së të drejtës dhe interesave të ligjshme të palëve. Cenimi duhet të bazohet në ligj dhe duhet të jetë në përputhje me procesin e rregullt që parashikon ligji. Pra, duhet të plotësohen kërkesat e procedurave administrative të rregulluara nga Kodi i Procedurave Administrative.

Neni 15 i K.Pr.A. bën të qartë mënyrën se si organet publike dhe punonjësit e tyre janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara ndaj palëve private kur kryejnë procedura administrative. Kjo siguron që as organet publike, as punonjësit e tyre përjashtohen nga përgjegjësia për dëmet e shkaktuara thjesht për shkak të faktit se ata duhet të kryejnë procedura administrative sipas të drejtës publike.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi, e çmon me vend dërgimin e këtij rekomandimi, duke shpresuar se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për rivënie në vend të së drejtës për zhvillimin e veprimtarisë administrative prej organeve tuaja, në përputhje me parimin e ligjshmërisë, i detyrueshëm për respektim në kuptim dhe zbatim të nenit 4 të Kodit të Procedurës Administrative.

Për arsytet e përmendura, në përputhje me nenin 63, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet, se:

“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëj rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”,

si dhe nenin 21, shkronja b), të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”,* të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDOJMË

Paraqitjen e kërkesës pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për zgjidhjen e çështjes së kompetencës administrative në trajtimin e çështjes për mirëmbajtjen dhe lirim të rrugës hyrëse në “Rrugën e Kombit”, por jo vetëm, nga Qyteti i Kuksit.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, në përputhje me nenin 19 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të kryhet mundësisht brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERE

Erinda MELI